**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**Keshilli i Ministrave**

# VENDIM

**Nr. 594 date 22-12-1997**

**PER**

**REGJISTRIN QE MBAN PUNEDHENESI PER PUNEMARRESIT E TIJ**

Ne mbeshtetje te ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 "Kodi i punes i Republikes se Shqiperise", me propozimin e Ministrise se Punes, Çeshtjeve Sociale dhe Gruas, Keshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratohet regjistri vjetor (Vit kalendarik) qe duhet te mbaje punedhenesi per punemarresit e punesuar prej tij.

2. Regjistri duhet te permbaje keto elemente kryesore:

   a) emri, atesia, mbiemri
   b) datelindja (dita, muaji, viti)
   c) adresa e vendbanimit
   d) shtetesia
   e) leja e punes (per te huajt e punesuar ne Shqiperi)
   f) tipi i kontrates se lidhur
   g) data e fillimit te punes
   h) arsyeja e nderprerjes se punes
   i) detyra ose vendi i punes, apo profesioni
   j) paga bruto mujore
   k) kohezgjatja e pushimit qe i takon, data ne te cilat jane marre pushimet dhe paga e dhene per pushimet vjetore te paguara
   l) derdhja e kontributeve te aktualizuara per çdo muaj
   m) numri i sigurimeve shoqerore
   n) paga sipas kontrates
   o) paga mbi te cilen derdhet kontributi
   p) tatimi mbi te ardhurat, si dhe zbritjet e tjera te parashikuara sipas nenit 117 te ligjit nr. 7961, date 12.7.1995
   q) pushime te tjera sipas kodit te punes, si dhe paga ne rastet kur jane me pagese
   r) ekzaminimi mjekesor paraprak dhe periodik çdo 6 muaj
   s) elemente te tjere qe i duken te domosdoshme punedhenesit

(periodiciteti i sigurimit teknik dhe masat disiplinore per punemarresit per shkelje te kodit te punes)

3. Regjistri eshte i detyruar per gjithe punedhenesit fizike dhe juridike, vendas e te huaj.

4. Punedhenesi eshte i detyruar ta vere ne dispozicion regjistrin sa hare qe kerkojne inspektori e punes dhe inspektori i sigurimeve shoqere.

Ky vendim hyn ne fuqi menjehere.

**KRYETARI I KESHILLIT TE MINISTRAVE**

**FATOS NANO**